

EKSPOZE E PUNIMIT
DIPLOMACIA E MBRETIT ZOGU I (1928-1939)

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I HISTORISË

NGA

BEHAR BESHIRI



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I HISTORISË
PRISHTINË

PRISHTINË, 2022

REZYME

DIPLOMACIA E MBRETIT ZOGU I (1928-1939)

NGA

BEHAR BESHIRI

Mentori: Selim Bezeraj, Prof. Asoc. Dr.

Historia e Shqipërisë lidhet ngushtë me procesin e pavarësisë kombëtare dhe diplomacisë së Mbretit Zogu I në politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit në periudhën e viteve 1928-1939. Pas zgjedhjeve të parakohshme, u propozua ndërrimi i formës së qeverisjes, u formua komisioni statusor, i cili propozoi ndërrimin e formës së regjimit nga republikë në monarki. Ky propozim u hodh në votim dhe parlamenti vendosi që Asambleja Kushtetuese të proklamojë Shqipërinë Mbretëri Demokratike Parlamentare të Trashëgueshme. Asambleja Kushtetuese proklamoi: “Mbret të Shqiptarëve” nën emrin “Zog I”. Ahmet Zogu krijoi një mbretëri moderne shqiptare, me ligje dhe standarde, dhe ekonomi të kohës që nuk i kishin shumë shtete perëndimore në atë kohë. Me mençuri dhe zgjuarsia ia arriti në një nivel të shkëlqyer për një kohë shumë të shkurtër, si me ligjet moderne të një kushtetute të përpunuar dhe të përshtatur për traditat dhe zakonet. Këtu duhet përmendur se në kohën e Mbretit Zog filluan reformat në çdo sektor. Politika e jashtme dhe diplomacia e Mbretit Zog u orientua drejt Perëndimit, Austrisë, Italisë, Francës, Gjermanisë, Britanisë dhe SHBA. Këto shtete ngelen jo vetëm prioritetet politiko-diplomatike, por edhe ekonomiko-tregtare.

Vitet 1925-1939 shënojnë një periudhë komplekse dhe mjaft të tendosur për historinë e Shqipërisë dhe për pozitën e vendit në Ballkan dhe në Evropë. Pozicioni i Shqipërisë në Ballkan kishte kohë që ishte përfshirë në planet strategjike italiane për zotërimin e detit Adriatik dhe të të gjithë Mesdheut. Mbreti Zog u tregua i gatshëm të merrte pjesë në procesin e depërtimit italian në Ballkan. Pas shumë negociatash me italianët, Zogu detyrohet të nënshkruajë dy traktate të rëndësishme në fushën e sigurisë: “Paktin e miqësisë dhe të sigurimit” dhe “Traktatin e Aleancës Mbrojtëse”.

Në luftërat grabitqare që u zhvilluan në fillim të shekullit XX-të fqinjët e Shqipërisë, si Jugosllavia, Greqia dhe Italia të gjithë këta në një formë apo tjetrën mundoheshin vazhdimisht ta shembnin shtetin edhe ashtu të brishtë Shqiptar, e cila sapo ishte krijuar më 28 nëntor 1912. Dy të parat, Jugosllavia dhe Greqia ishin këta që ta pushtonin tërësisht Shqipërinë dhe ta përdornin si bazë për pushtimin e tërë Ballkanit, atëherë kur të vjen momenti i përshtatshëm.

Në këtë rrjedhje ngjarjesh, u zhvillua intensivisht diplomacia e Mbretit të Shqipërisë, Ahmet Zogu, e cila me ndikimet e brendshme dhe të jashtme të vendit kishte për synim të qarta që Shqipërinë të mbante sa më larg luftërave. Gjithashtu, të përfitonte nga kontradiktat e fuqive të mëdha dhe atë të fqinjëve për ta mbajtur Shqipërinë jashtë konflikteve bashkëkohore me qëllim për të bërë një shtet të zhvilluar ekonomikisht, politikisht dhe ushtarak, e nga ana kulturore sipas modeleve të demokracive perëndimore.

Kjo diplomaci ka tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve dhe analistëve vendas dhe të huaj në periudhat para dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Diplomacia e Zogut, s'është bërë objekt i një monografie të mirëfilltë, por janë trajtuar vetëm aspekte të veçanta të asaj diplomacie. Lidhur me figurën e Ahmet Zogut I Mbretit të Shqiptarëve, më gjerësisht kanë dhënë opinionet autorët italianë, ku këta me shkrimet e tyre ndjehet haptazi antishqiptarizmi. Një varg publikime të shkruara nga diplomatët italian, të cilët kishin vepruar në Shqipëri, problematikën e Zogut e trajtonin nga këndvështrimi shkencëtar si jo objektivitet. Për më tepër, pikëpamjet e atyre autorëve italian që kishin shërbyer si diplomat në Shqipëri shfaqnin miratimin e politikës shtetërore Italiane për aneksimin – pushtimin e Shqipërisë.

Prandaj, ky punim do të shtjelloj në mënyrë objektive diplomacinë nën udhëheqjen e Mbretit të Shqipërisë Ahmet Zogun në periudhën 1928 – 1939. Ky studim bazohet në një qasje kronologjike mbi diplomacinë e Mbretit Zogu I, gjithashtu, studimi trajton historinë e Shqipërisë mes viteve të përmendura, më pas biografinë e Mbretit Zogu I me zhvillimin e misionit ndër-luftarak dhe raportet politike. Diplomacia e Ahmet Zogut ka luajtur një rol të rëndësishëm gjatë të kaluarës së Shqipërisë.

Struktura e punimit të ndarë në kapituj vë në pah si objektiv kryesor pasqyrimin e qëndrimit të Ahmet Zogut ndaj Shqipërisë e vendeve fqinje, Ballkanin dhe më gjerë, të hulumtuar nga autorë dhe historian më eminent të historisë moderne për Mbretin e Shqiptarëve Zogu I.

Diplomacia e Mbretit Zogu I do të dilte më mirë në pah po të hidhej pak dritë mbi rrethanat e brendshme dhe të jashtme që ndodhej Shqipëria gjatë periudhës që ai mori në duar pushtetin në vend.

Ndër fiset e lashta patriotike shqiptare është edhe ai Zogolli, i cili nga mbarimi i shekullit XV-të, duke qenë në luftë të vazhdueshme me qeverinë osmane, lanë trevat dhe në malësinë e Gjakovës dhe u vendosen në viset strategjike të Matit, në Burgajet. Trimëria e burrave të kësaj familjeje respektohej nga fiset tjera të cilat e thërrisnin ata shpesh në luftërat që bënin kundër pushtuesit osman. I pari i këtij fisi, Zogu për trimërinë dhe veprimtarinë kundër osmanëve u quajt nga populli “Zogu i Madh”. Për pesëqind vjet rresht familja Zogu e qeverisi Matin duke qenë në lufta të vazhdueshme me qeverinë osmane. Ahmet Zogu ishte bir i këtij fisi.

Ahmet Zogu lindi në Burgajet të Matit, më 8 tetor 1895. Mësimet e para i mori në vendlindje nga mësues privat si Sali Toron, Hysen (Efendi) Cekën dhe Dervish Himën për gjuhën shqipe, Hafiz Muharremin për gjuhën turke, deri në moshën 13 vjeçare. Pas vdekjes së t'atit më 1908, u bë Beu i Matit, i quajtur edhe Beu i vogël. U zgjodh në vend të vëllait Xhelal bej Zogolli. Pas vdekjes së Xhemal pashës timonin e drejtimit të familjes e mori shoqja, nënë Sadija, bijë e fisit të lashtë patriot Toptani e Shqipërisë së Mesme. Vëmendje të veçantë tregoi ajo për djalin e saj të vetëm. Ahmeti ishte fëmijë inteligjent e temperament të gjallë, i shkathët e tepër i lëvizshëm, ku spikasnin guximi, rrëmbimi, gjakftohtësia e sidomos dëshira për artin ushtarak dhe komandimin.

Kultura kombëtare është veçoria e një kombi. Ajo e ngre lart vetëdijen kombëtare, duke i dhënë rëndësinë e meritueshme. Historia na jep mjaft shembuj se, shumë kombe të mëdha janë zhdukur nga faqja e dheut, vetëm për shkak të humbjes së kulturës kombëtare. Tradita e funksionimit të shtetit shqiptar, është ndërlydhur me fronin mbretëror. Mbreti i parë i shqiptarëve, Ahmet Zogu, gjithmonë kishte për synim krijimin e një ushtrie të fortë, në mënyrë që të krijojë shtetin real shqiptar, bazuar në realitetin historik e nacional. Jo rastësisht, Mbreti Zog, kalonte kohë të tëra, duke drejtuar e forcuar ‘Ushtrinë Kombëtare për Çlirimin e Shqipërisë Etnike’. Historia e Komitetit të Kosovës deri në vitin 1923 ishte tërësisht e lidhur me lëvizjen e përgjithshme çlirimtare shqiptare, por nga fundi i vitit 1923 liderë të caktuar si Zija Dibra, Bajram Curri etj., nën ndikimin e forcimit të luftës revolucionare gjithë ballkanike, filluan të orientohen kah Fronti i

përbashkët revolucionar, ndaj dhe bashkëpunonin me të gjithë faktorët revolucionarë në Ballkan dhe jashtë tij³³. Gjatë vitit 1924, Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës, kryetar i të cilit ishte Hasan Prishtina, vazhdonte të ishte faktor i rëndësishëm revolucionar jo vetëm në Kosovë e Shqipëri, por dhe në Ballkan dhe si gjithëherë qëllimi themelor i Komitetit ishte bashkimi i Kosovës me Shqipërinë.

Shkëmbimi i popullsisë, megjithëse zyrtarisht ishte pezulluar, vijoi ende. Në janar 1927 qeveria e Kondilisit nisi një fushatë të re të shpërnguljes së shqiptareve, ajo i kërkoi qeverisë turke t'i hapte portat për popullsinë çame. Ankaraja kishte kundërshtuar këtë kërkesë me argumentin se binte në kundërshtim me vendimet e Lidhjes së Kombeve, me vetë angazhimet e qeverisë greke dhe me kërkesat e drejta të popullsisë çame myslimane. Por presionet e shumta dhe permanente, diferencimi i vazhdueshëm me qytetarët grekë, shkëmbimi dhe moskthimi i pasurive etj, quan herë pas here, që familje dhe grupime të lodhura të popullsisë, të kërkonin të shpërnguleshin, kur kjo nuk duhej të lejohej sepse zyrtarisht ishte ndërprerë procesi i shkëmbimit në Greqi.⁴²

Qeveria e Ahmet Zogut vazhdimisht e mbikëqyrte fatin e popullsisë Çame në Greqi, Përmes një memorandumit, që iu dërgua Qeverisë së Athinës më 3 shkurt 1928, Qeveria shqiptare e akuzonte se si rezultat mosrealizimit të asnjë të drejte që i parashtronte edhe vetë kushtetuta greke, popullsia çame detyrohej që t'i braktisë trojet e veta dhe të kërkonte strehim në Shqipëri.

Marrëdhëniet diplomatike midis Shqipërisë dhe Britanisë së Madhe janë vendosur në 9 nëntor 1921. Britania e Madhe, para qeverisë së Nolit, me përfaqësuesin e saj, Hary Ejers, kishte krijuar me Ahmet Zogun marrëdhënie që funksiononin mirë. Përfaqësuesi britanik pohonte se Zogu kishte krijuar stabilitetin e shumëpritur, ndërsa Noli nuk paraqitej i pranuar sidomos në marrëdhënie me fqinjët. Qeveritë para asaj ishin ndodhur në vështirësi të mëdha ekonomiko-financiare. Me ardhjen e Zogut kryeministër qeveria u ndodh në vështirësi të mëdha ekonomiko-financiare. Përballë refuzimit nga Lidhja e Kombeve dhe rekomandimit për Italinë, qeveria shqiptare shihte si alternativë për zhvillimin e vendit edhe shfrytëzimin e pasurive mbi tokë dhe nëntokë të vendit me anë të kapitalit të huaj.

Vlen të theksohet se Presidenti Ataturk, sidomos gjatë viteve 1930-1934, kur zhvillohej lidhja ballkanike dhe kur priste në audiencë ministrat e Shqipërisë, nuk zinte në gojë emrin Ahmet Zogu,

por vlerësonte marrëdhëniet vëllazërore shekullore turko-shqiptare dhe kombit shqiptar i uronte lumturi, begati, qetësi e paqe.

Ishin vitet '30 kur bota hyri në depresionin më të madh në histori, dhe si gjendje e tillë i dha shkak krijimit të ideologjive të reja dhe të rrezikshme. Në Itali kishte fituar fashizmi me kohë, por dalë ngadalë ai mbolli farën e militarizmit dhe të imperializmit. Në Gjermani nga fillimi i viteve '30, fitoi dhe një tjetër ideologji nazizmi. Krerët e këtyre vendeve, Musolini dhe Hitleri, u binden se veç ata mund të shpëtonin botën nga kriza e madhe ekonomike, duke rrëzuar demokracinë dhe me vendos, sipas tyre, regjime një partiake dhe me qeveris me një rregull të caktuar nga shteti. Kjo rryme filloi me influencua edhe Shqipërinë. Shqipëria që nuk kishte asgjë kur u shpall e vetëqeverisur që nga Kongresi i lidhjes filloi të kërkonte ndihmë dhe kjo iu akordua sipas rregullave internacionale. Kjo ndihme ishte më e përshtatshme me u mbështet në Italinë, sepse ishte i vetmi vend fqinj që nuk kishte më asnjë pëllëmbë tokë tonën. Kështu behej një kundër ballans përballë shteteve grabitqare: Greqisë dhe Jugosllavisë. Qeveria nga shqiptare e udhëhequr nga Mbreti Zogu I bëri të ditur se do të kultivonte marrëdhënie të mira me të gjitha shtetet, dhe veçanërisht me fqinjët e sajë dhe do të zbatonte të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë aleancën e përfunduar me aleatën e saj të madhe dhe fisnike Italinë. Mbreti Zogu I mendonte se me një monarki të fortë mund të përfitonte më shumë nga aleanca italo-shqiptare dhe do të kishte më shumë autoritet në Ballkan dhe në Evropë, gjendja e rëndë ekonomike nuk jepte shumë shpresë për këtë.

Italia fashiste kishte kohë që përgatitej për pushtimin e Shqipërisë qoftë në mënyrë “paqësore” nëpërmjet presioneve në fushën politike, ekonomike, ushtarake dhe financiare, qoftë edhe me forcën e armatosur. Pasi dështuan përpjekjet e vazhdueshme dhe ultimatumit i fundit për ta detyruar Mbretin Zog, Parlamentin dhe qeverinë shqiptare që të nënshtroheshin, qeveria italiane vendosi të përdorë forcën e armatosur për të pushtuar Shqipërinë. I gjendur përpara provës më të vështirë të kohës, Zogu ideoi qëndresën. Në rastin më të mirë, parashikohej një qëndresë serioze duke shpresuar edhe të mbështetja e ndërkombëtarëve. Në mungesë të kësaj mbështetjeje, sigurisht që qëndresa shqiptare do të ishte simbolike. Për këtë, duke sensibilizuar çfarë po përgatiste Italia kundër Shqipërisë, u bëri thirrje fuqive të Antantës Ballkanike, Fuqive të Mëdha të Evropës dhe SHBA që të ndërhynin në Romë, për të ndaluar sulmin e Italisë, ose të jepej mbështetja e duhur për të përballuar rrezikun që po i kanosej Shqipërisë. Ndërkohë, Mbreti Zog kishte filluar të organizoj

qëndresën ushtarake, duke ndërtuar një koncept të qartë të mbrojtjes strategjike: qëndresë sa të ishte e mundur në vijën bregdetare me qëllim rraskapitjen e forcave pushtuese dhe pastaj, përballimi i tyre me luftë guerilje, duke u mbështetur në terrenin malor të vendit, në patriotizmin shqiptar si dhe në mbështetjen e mundshme nga jashtë.

Pjesa më e errët e veprimtarisë së Mbretit Zog cilësohet largimi nga Shqipëria, një veprim që pavarësisht sqarimeve të tij dhe familjes, edhe sot mbetet e pashpjegueshme nga historianët. Ai duke mos pranuar kushtet e pushtimit fashist, migron nga Shqipëria.

Bazuar në studimin e mësipërm, argumenti kryesor i këtij punimi ishte analiza e sundimit të Mbretit Zogu I në Shqipëri gjatë viteve 1928 – 1939. Prandaj, ky punim trajtoi diplomacinë e Mbretit Zogu I dhe vjen në përfundim se ai shihet si një personazh i aftë për të stabilizuar Shqipërinë duke krijuar kushtet e nevojshme për krijimin e ndërgjegjes individuale shqiptare, përgjegjësisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare.